



## Ngadhënjimi i teologjisë (ilm el-kelam)

### Description

Imam Eshariu (vd. rreth 936 e.s.)

Përkthim i libërthit të shkruar nga Ebu el-Hasan 'Ali b. Ismail el-Eshariu, "Ris'ala (fi) istihsan el-khaud f? 'ilm al-kelam (Ese rreth preferimit të kredhjes në dijen e ilm al-kelamit [teologjisë islame]), në " *A Vindication of the Science of Kalam*", tr. McCarthy, p. 119-134.

Me emrin e Zotit, të Mëshirshmit, Mëshirëplotit

[...]

Lavdërimi i takon Allahut, Zotit të Botëve! Dhe bekimet e Zotit qofshin mbi Muhamedin, Profetin, dhe familjen e tij të mirë, dhe Shokët e tij, Imamët e përzgjedhur!

### **OBJEKSIONI NDAJ KELAMIT**

2. Një grup i caktuar njerëzish<sup>[1]</sup> e kanë bërë injorancën kapital të tyre. Duke menduar se arsyetimi dhe hulumtimi në besimin fetar është tejet kaba, ata piren drejt lehtësimit (tekhf?f) dhe taklidit (imitimit te verber)<sup>[2]</sup>. Ata shpifin kundër atyre që shqyrtojnë me imtësi dogmat e fesë dhe i akuzojnë ata për paudhësi (dalalet). Është risi (*bidat*) dhe paudhësi (dalalet), pretendojnë ata, që të angazhohesh në kelam në lidhje me lëvizjen dhe prehjen, trupin (xhism) dhe aksidencën (a?rad), mënyrat dhe gjendjet aksidentale (*al-aluan ua'l-aku?n*)<sup>[3]</sup>, atomin (al-xhuz?) dhe brofjen (tafra)<sup>[4]</sup>, dhe cilësitë e Krijuesit.

3. Ata pohojnë se në qoftë se kjo do të ishte një çështje udhëzimi dhe sjelljeje të drejtë (rashad), Profeti, Kalifët pas tij si edhe Shokët (sahabët) e tij të Nderuar do ta kishin diskutuar atë. Sepse, thonë ata, Profeti nuk vdiq pa i diskutuar dhe shpjeguar gjerësisht të gjitha çështjet e domosdoshme fetare. Nuk ka vend për askënd pas tij që thotë diçka në lidhje me çështjet e fesë që janë të domosdoshme për myslimanët, dhe rreth asaj çka i afron ata me Zotin dhe i largon nga mëria e Tij.
4. Duke qenë se asnjë prononcim (kelam) mbi ndonjë të ndonjë prej temave që ne kemi përmendur nuk është përcjellur nga Profeti, ne e dimë se një kelam i tillë është një risi (bidat) dhe se një hulimtim i tillë një paudhësi/devijim (dalalet). Sepse në qoftë se ilm el-kelami do të ishte i mirë, Profeti dhe Shokët e tij të Nderuar nuk do të kishin ngurrar që ta diskutonin atë. Mungesa e një kelami të tillë nga ana e Profetit dhe Shokëve të tij mund të shpjegohet në vetëm dy mënyra: ose ata e dinin atë dhe qëndruan në heshtje për të; ose ata nuk e dinin atë, madje ishin edhe të paditur për të. Në qoftë se ata e kanë ditur atë dhe nuk e kanë diskutuar, atëherë ne gjithashtu mund të qëndrojmë në heshtje për të, sikundër vepruan ata, dhe mund të përmbahemi nga të kredhurit në të, sikundër u përmbajtën ata. Sepse në qoftë se ai (kelami) do të ishte një pjesë e fesë, ata nuk do të kishin qëndruar në heshtje në lidhje me të. Në krahun tjetër, në qoftë se ata nuk e njihnin atë, atëherë ne mund të kemi të njëjtën padituri në lidhje me të. Sepse në qoftë se kelami do të ishte pjesë e fesë, ata nuk do të kishin qenë të paditur për të. Kështu pra, sipas të dyja shpjegimeve, një kelam i tillë është risi dhe të kredhurit në të është paudhësi.

## **PËRGJIGJA E PARË**

5. Ka tre mënyra për t'iu përgjigjur këtij argumenti. E para është që t'u kthehet pyetja kundër tyre duke thënë: Është po aq e vërtetë se Profeti kurrë nuk ka thënë: "Në qoftë se dikush duhet të hulimtojë në ilm el-kelam dhe ta diskutojë atë<sup>[5]</sup>, shiheni atë si një rijësues (bidatçi) të paudhë". Kështu që, ju jeni të shtrënguar që ta shihni veten si rijësues të paudhë, duke qenë se ju keni diskutuar diçka që Profeti nuk e ka diskutuar, dhe ju e keni akuzuar për paudhësi, apo devijim, atë të cilin Profeti nuk e ka akuzuar.

## **PËRGJIGJA E DYTË**

6. Përgjigja e dytë është që atyre t'u thuhet: Në të vërtetë, Profeti nuk ishte i paditur për asnjë të ndonjë prej pikave të kelamit që ju keni përmendur në lidhje me trupin dhe aksidencën, lëvizjen dhe prehjen, atomin dhe brofjen. Është e vërtetë<sup>[6]</sup> se ai nuk diskutoi çdonjë të ndonjë prej këtyre pikave specifikisht; dhe e njëjta gjë është e vërtetë për juristët<sup>[7]</sup> dhe të diturit nga gjiri i Sahabëve të Nderuar (të Profetit). Megjithatë, parimet themelore të këtyre gjërave që ju keni përmendur specifikisht janë të pranishme Kur'an dhe në Sunet në terma të përgjithshëm, jo në imtësi.
7. Merrni lëvizjen dhe prehjen dhe kelamin në lidhje me to. Parimi i tyre themelor është i pranishëm në Kur'an, ku ato vërtetojnë afirmimin e njëshmërisë së Zotit: dhe kështu qëndron puna edhe për bashkimin dhe ndarjen. Teksa rrëfen atë çka miku i Tij, Ibrahim, tha në ngjarjen për përditimin e yllit dhe diellit dhe hënës dhe faktin që ato lëvizin nga një vend në një tjetër,<sup>[8]</sup> Allahu tha atë çka

vërteton se Zoti i tij (i Ibrahimit) nuk mund t'i nënshtrohet asgjëje të tillë, dhe se ai që i nënshtrohet perëndimit dhe transferimit nga njëri vend në një tjetër nuk është kurrsesi hyjni.

8. Kelami mbi parimet themelore të njëshmërisë së Zotit është gjithashtu i nxjerrë nga Kur'ani. Zoti thotë: “Sikur të kishte perëndi të tjera krahas Zotit në to, qiejt dhe toka do të ishin në çrregullsi” (Kur'an 21:22). Ky kelam i përmbledhur është një përkujtues i argumentit se Zoti është unik dhe i pashoq[9], dhe se kelami i kelamistëve (*mutekelimun*), në të cilin ata argumentojnë për njëshmërinë hyjnore duke u mbështetur tek pamundësia tamanua dhe tejkalimi/mbizotërimi (taghalub) thjesht zë fill tek ky ajet. Zoti gjithashtu[10] thotë: Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s'ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin (Kur'an: 23-91-93). Dhe kështu derisa[11] Ai tha: “Apo ata i veshin Allahut ortakë, të cilët krijojnë siç krijon Ai, kështu që krijimi kështu që krijimi u ngjan i njëjtë atyre(idhujtarëve)?!” (Kur'an 13: 16-17) Kelami i kelamistëve, ku ata argumentojnë në lidhje me njëshmërinë e Allahut, thjesht zë fill në këto ajete që ne sapo i kemi përmendur. Dhe ngjashëm, i gjithë kelami që trajton në hollësi çështjet që rrjedhojnë nga dogmat themelore të njëshmërisë dhe drejtësisë së Zotit thjesht është marrë nga Kur'ani.
9. Kështu qëndron puna edhe me kelamin mbi mundësinë dhe pamundësinë e ringjalljes (së trupit). Kjo çështje është debatuar gjerë e gjatë nga arabët inteligjentë dhe nga të tjerë përpara tyre derisa ata mbetën të mahnitur nga mundësia e ndodhjes së saj dhe thanë: “Çfarë! Kur ne të kemi vdekur dhe të jemi bërë pluhur? Ai është një rikthim i pabesueshëm!” (Kur'an 50:3); dhe: “Kurrë, kurrë një shpresë për atë që ju është premtuar!” (Kur'an 23:36); dhe: “Kush do t'i zgjojë eshtrat kur ato të jenë tretur?” (36:78); dhe fjalët e Zotit: “A ju premtun ai se kur ju të keni vdekur dhe të jeni bërë pluhur e eshtra ju do të silleni në jetë?” (23:35-37) sa i përket një kelami të tillë të tyre, Zoti vendosi në Kur'an argumentin e projektuar që të konfirmonte, nga këndvështrimi i arsyes, mundësinë e ringjalljes pas vdekjes. Krahas kësaj, Ai e mësoi dhe e udhëzoi Profetin e tij se si të debatonte kundër mohimit që ata i bënë ringjalljes në dy mënyra, sipas dy grupeve të kundërshtarëve[12]. Njëri grup e pranonte krijimin e parë, por e mohonte të dytin, ndërkohë që grupi tjetër i mohonte të dy[13] me arsyetimin se bota është e përjetshme.
10. Kundër atij i cili pranoi krijimin e parë, Zoti[14] argumentoi duke thënë: “Thuaj: I ngjallë Ai që i krijoi për herë të parë” (Kur'an 36:79), dhe duke thënë: “Është Ai që jep jetë nëpërmjet një krijimi të parë, dhe më pas e përsërit atë; dhe kjo është edhe më e lehtë për atë” (Kur'an 30:26-27), dhe nëpërmjet fjalëve të Tij: “Ashtu sikur Ai ju bëri së pari, ju do të ktheheni tek Ai” (Kur'an 7:228-29). Me anë të këtyre ajeteve, Ai u ka tërhequr atyre vëmendjen në faktin se ai që është në gjendje të kryejë diçka pa referencë ndaj një ekzemplari paraekzistues është edhe më i aftë që të kryejë diçka që është prodhuar tashmë. Dhe me të vërtetë, kjo e dyta është e më lehtë për Atë, sikundër ju e dini nga vetë përvoja juaj. Por në rastin e Krijuesit, nuk është “më e lehtë” për Atë që të krijojë një gjë se sa të krijojë një tjetër.

[15] Është thënë se parashtesa përemrore në *'aleihi* (për atë) është një aluzion për kapacitetin e krijesave, kuptimi i së cilës është: Është më e lehtë dhe më pak e rëndë për njërin prej jush që të ngrihet dhe të rikthehet se sa të krijohet për herë të parë. Është kështu për shkak se krijimi i tij i parë është gjithnjë i bashkëlidhur me lindjen, rritjen, prerjen e kordonit të kërthizës, mbështjelljen me pelena, daljen e dhëmbëve, dhe shenja të tjera të dhimbshme dhe trazuese, ndërkohë që rikthimi i tij lipsvetëm një çast të vetëm ku nuk ka asgjë nga ato vuatje që përmendëm. Prandaj, rikthimi i tij është më i lehtë për atë vetë se sa krijimi i tij i parë.

Ky, pra, ishte argumenti që Zoti [16] solli kundër grupit që e pranonte krijimin.

11. Sa i përket grupit që mohonte si krijimin e parë ashtu dhe të dytin, dhe pohonte përjetësinë e botës, (ky ishte) një dyshim që hyri në mendjen e tyre thjesht për shkak se ata thanë: “Përvoja na thotë se jeta është e njomë dhe e ngrohtë, dhe vdekja është e ftohtë dhe e thatë, ngjashëm me natyrën e dheut. Si mund të ketë, pra, ndonjë shkrirje [17] të jetës, dheut dhe eshtrave të tretura, që të rezultoj në një krijim të saktë, duke qenë se dy të kundërta nuk kombinohen?” Për këtë arsye, pra, ata e mohuan ringjalljen.

12. Është pa diskutim e vërtetë se dy të kundërta nuk kombinohen në një substrat, apo në një drejtim të vetëm, apo në atë që ekziston (tashmë) në substrat. Por ato mund të ekzistojnë në dy substrate nëpërmjet afërsisë (muxhauara). Kështu që Zoti argumentoi kundër tyre duke thënë: “Ai që prej pemës së gjelbër ju bëri zjarrin, e ju prej tij ndezni” (Kur’ani 36:80). Duke thënë këtë, Zoti i referoi ata tek dija dhe përvoja që ata kishin mbi shfaqjen e zjarrit nga pemët e gjelbërta, pavarësisht nga nxehtësia dhe thatësia e të parit dhe ftohtësia dhe lagështia e të dytave. Sërish, Zoti e bëri mundësinë e prodhimit të të parës (d.m.th. zjarrit) një argument të mundësisë së ringjalljes në Ditën e Gjykimit, për shkak se ai është një argument i afërsisë/ngjashmërisë së jetës me tokën dhe eshtrat e tretura dhe me bërjen e saj një krijim i shëndoshë – sepse Ai tha: “Pikërisht sikundër ne krijuam njeriun për herë të parë, kështu kemi për ta rikthyer atë” (21.104)

13. Sa i përket diskutimit të *mutekelimunëve* që përfshin (principin) se gjërat e origjinuara (hauadith) që fillojnë të ekzistojnë kanë një pjesëtar të parë, dhe refuzimi që ata i bëjnë materialistëve/temporalistëve (dahrije) të cilët pohojnë se nuk ka asnjë lëvizje që nuk pararendet nga lëvizje, dhe asnjë ditë që nuk pararendet nga një ditë tjetër, dhe kelami kundër tij i cili pohon se nuk ka asnjë atom që nuk mund të përgjysmohet në pafundësi – ne e gjejmë bazën për këtë në Sunetin e të Dërguarit të Allahut. Në një rast të caktuar, ai ka thënë: “Nuk ka asnjë sëmundje ngjitëse dhe asnjë ogur të keq.” [18] Dhe një beduin i tha: “Atëherë si qëndron puna me devetë, të patëmeta mu si gazelat, të cilat përzihen me deve që u ka rënë zgjebja, dhe edhe ato bëhen me zgjebe?” Dhe Profeti i tha: “Dhe kush e infektoi të parën?” Dhe beduini nuk foli, për shkak të asaj që Profeti e kishte bërë të kuptonte nëpërmjet këtij argumenti racional. Në mënyrë të ngjashme, ne i themi atij që pretendon se nuk ka asnjë lëvizje që nuk është paraprirë nga një lëvizje: Në qoftë se do të ishte kështu, atëherë asnjë lëvizje e vetme nuk do të kishte filluar ndonjëherë të ishte, sepse çka është e pafundme (paraprakisht) nuk mund të fillojë të jetë [pra nuk mund të vijë në ekzistencë] (ma la nihaje lehu ma hadeth lehu).

14. Në mënyrë të ngjashme, kur një njeri i caktuar tha: [19] “O Profet i Zotit! Bashkëshortja ime ka sjellë në jetë një djalë me ngjyrë të zezë” – dhe (me këtë) ai aludoi se nuk do ta njihte si fëmijën e tij – Profeti i tha: “A ke deve?” Ai iu përgjigj: “Po!” Profeti i tha: “Çfarë ngjyre kanë ato?” Ai tha: “Të kuqerremta.” Dhe i Dërguari i Zotit i tha: “A ka ndonjë deve bojëhiri në gjirin e tyre?” Ai tha:

“Po, ka një deve bojëhiri në gjirin e tyre.” Profeti i tha: “Dhe prej nga ka ardhur ajo?” Ai tha: “Ndoshta një djesitje[20] e ka prishur atë.” Dhe Profeti i tha atij: “Dhe ndoshta një djesitje e ka prishur tët bir.” Kjo, pra, është mënyra në të cilën Zoti e mësoi Profetin e Tij që t’ia referonte diçka llojit dhe të ngjashmit të saj, dhe ky është themeli jonë në të gjitha gjykimet që ne bëjmë në lidhje me të ngjashmet dhe të përafërtat.

15. Ne e përdorim këtë argument kundër atij që pohon se Zoti u përngjan krijesave dhe është një trup, duke i thënë:[21] Në qoftë se Zoti do t’i përngjante diçkaje, Ai do të duhej t’i përngjante ose në të gjitha aspektet ose në njërin nga aspektet e saj. Në qoftë se Ai i ka përngjarë asaj në të gjitha aspektet, Ai prej domosdoshmërisë do të ishte i origjinuar (muhdath) në të gjitha aspektet e Tij. Dhe në qoftë se Ai do t’i përngjante në njërin prej aspekteve të saj, Ai prej domosdoshmërisë do të ishte i origjinuar, njëlloj si ajo, në atë aspekt në të cilin Ai i përngjan asaj. Sepse çdo dy gjëra të ngjashme gjykohen njëlloj në lidhje me atë në të cilën ato janë të ngjashme. Por është e pamundur për të origjinuarin që të jetë i përjetshëm, dhe për të përjetshmin që të jetë i prodhuar. Dhe vërtet Zoti ka thënë: “Nuk ka asgjë të ngjashëm me Atë” (42.11/9), dhe Ai ka thënë: “Nuk ka asnjë të barabartë me Atë” (112.4).
16. Baza për të thënë se trupi ka një limit, dhe se atomi nuk mund të ndahet (në pafundësi), është thënia e Zotit: “Dhe gjithçka është numëruar prej nesh në një arketip të qartë” (Kur’an 36:11-12). [22] Ajo që nuk ka limit nuk mund të numërohet, dhe gjëja e vetme nuk mund të ndahet (në pafundësi). Sepse kjo do të kërkonte që ato të ishin (pafundësisht) dy gjëra – dhe Zoti ka deklaruar se numërimi i zbatohet të dyja atyre.
17. Baza për deklarimin se akti duhet të kryhet nga sjellësi në ekzistencë (muhdith) i botës sikundër Ai synon dhe zgjedh, dhe në mungesë të ndonjë mospëlqimi nga ana e Tij, është thënia e Zotit: “A nuk e shihni se çfarë ejakuloni? A jeni ju ata që e krijoni atë? Apo jemi Ne që e krijojmë?” (Kur’an 56:58-59). Dhe ata nuk mund të pohonin me argument se ata krijuan (atë).[23] Pavarësisht nga dëshira e tyre për të patur fëmijë, ai nuk do të vinte në jetë në qoftë se Zoti nuk do të kishte dashur që të vinte. Kësodore, Zoti tërhoqi vëmendjen e tyre në faktin se Krijuesi është Ai nga i cili krijesat vijnë, në përputhje me synimin e Tij.
18. Baza për përgënjeshttrimin racional të kundërshtarit tonë është marrë nga Suneti i Zotërisë sonë, Muhamedit. Unë i referohem mësimin që ai mori nga Zoti kur ai u takua me rabinin me trup të shëndoshë dhe i tha atij: “Unë të kujtoj, për Allah, a nuk të duket në atë që Zoti ka shpallur prej Torahut se Zoti e urren rabinin e shëndoshë?” Dhe rabinin e kaploi zemërimi nga ky qortim, dhe tha: “Allahu nuk i ka shpallur gjë asnjë qenieje njerëzore!” (Kur’an 6:91) Atëherë, Zoti tha[24]: “Thuaj: Kush e zbriti Librin që Moisiu pruri si dritë dhe udhëzim për njerëzit?” e deri në fund të ajetit (Kur’an 6:91). Kështu, ai e përgënjeshtroi atë me shpejtësi, për shkak se Torahu është një gjë, dhe Moisiu një qenie njerëzore, dhe rabini pranoi se Zoti i kishte zbritur Torahun Moisiut. Dhe në mënyrë të ngjashme, ai përgënjeshtroi ata njerëz që pretendonin se Zoti u kishte porositur atyre që ata të mos i besonin një të dërguari derisa ai të vinte me një kurban që do ta përpinte zjarri (Kur’an 3:183-179). Zoti ka thënë: “Thuaj: Para meje juve ju kanë ardhur të dërguar me argumente, dhe pikërisht me këtë gjë që e përmendët. Atëherë, përse i mbytët ata nëse jeni të sinqertë?” (Kuran 3:183) Dhe nëpërmjet kësaj Ai i përgënjeshtroi ata dhe argumentoi kundër tyre.
19. Baza jonë në korrigjimin e arsytimit të shtrembër të kundërshtarëve tanë është marrë nga fjalët e Zotit: “Ju dhe ata që ju adhuroni, përpos Allahut, do të jeni lëndë zjarri për Xhehenemin. Ju po i

afroheni atij! Në qoftë se këto perëndi të rreme do të ishin hyjni, ata nuk do të kishin arritur atje [në Xhehenem]. Gjithçka do të jetë atje përjetësisht. Atje ata do të nxjerrin ofshama, por ato nuk do të [25] dëgjohen” (Kur’an 21:98-100). Sepse kur zbriti ky ajet [26], Abdullah bin el-Ziha’rasë – një njeri polemik dhe grindavec – i mbërriti fjalë për të dhe ai tha: “Unë kam triumfuar më së miri mbi Muhamedin dhe Zotin e Qabesë!” Më pas, i Dërguari i Zotit shkoi tek ai, dhe Abdullahi i tha: “O Muhamed, a nuk pretendon ti vallë se Jezusi dhe Uzejri dhe ëngjëjt janë adhuruar?” Dhe Profeti nuk foli [27], jo nga pështjellimi apo nga mungesa e diçkaje për të thënë, por nga habia përballë injorancës së Abdullahit, sepse në ajet nuk ka asgjë ku hyn Jezusi dhe Uzejri dhe ëngjëjt. Sepse Zoti ka thënë: “dhe ata që ju adhuroni”; por, Ai nuk tha: “dhe gjithçka që ju adhuroni, përpos Zotit.” Por Ibn el-Ziha’ra thjesht donte të argumentonte në mënyrë të çuditshme kundër Profetit, në mënyrë që të bënte njerëzit e tij të mendonin se ai kishte argumentuar me sukses kundër Muhamedit. Kështu që Zoti zbriti ajetin: “Vërtet, ata që kanë marrë tashmë prej nesh më të mirën (shpërblimin)” – pra, ata prej tyre që adhurohen – “janë larg prej tij (Xhehenemit)!” (Kuran 21:101). Profeti mandej recitoi atë ajet, dhe pas kësaj ata ia dhanë një britme të madhe për të maskuar pështjellimin dhe gabimin e tyre, dhe ata thanë: “A janë hyjnitë tona më të mira, apo është ai?” – pra, Jezusi. Kështu që, Zoti zbriti ajetet: “Kur i Biri i Merjemes paraqitet si shembull, shikoni se si populli juaj i kthen shpinën atij. Ata pyesin: “A janë hyjnitë tona më të mira apo ai?” Ata ta kanë propozuar ty këtë shembull vetëm për hir të polemizimit. Ata janë me të vërtetë një popull grindavec” (Kuran 43:57-58) [28]

20. Të gjitha ajtet që i kemi përmendur, si edhe ato të shumta që nuk i kemi përmendur, janë një bazë dhe argument për ne në kelamin tonë mbi atë që përmendim në hollësi. Është e vërtetë se asnjë çështje nuk është trajtuar në veçanti në Libër dhe Sunet. Por kjo ka ndodhur për shkak se trajtimi në veçanti i çështjeve që përmbajnë principe racionale nuk ka ndodhur në kohët e Profetit. Megjithatë, (ai dhe) Sahabët janë përfshirë në kelamin e tipit që ne kemi përmendur. [29]

## **PËRGJIGJA E TRETË**

21. Përgjigja e tretë është se i Dërguari i Allahut i dinte këto çështje për të cilat ata kanë pyetur, dhe ai nuk ishte i paditur për asnjë hollësi që gjendej në to. Megjithatë, ato nuk janë shfaqur në kohën e tij në formë kaq specifike sa që ai duhet t’i diskutonte, apo nuk duhet t’i diskutonte ato – madje edhe pse principet e tyre themelore ishin të pranishme në Kur’an dhe Sunet. Por sa herë që ngrinte kryet një çështje që ka qenë e ndërlidhur me fenë nga pikëpamja e Ligjit, njerëzit e diskutonin atë, dhe hetonin në brendinë e saj, dhe diskutonin rreth saj, dhe debatonin e argumentonin. Të tilla, për shembull, ishin çështjet që kishin të bënin me pjesën e trashëgimisë [30] që i takonte gjysheve – që është njëra prej çështjeve që përmban detyrimet – dhe çështje të tjera që preknin përcaktimet ligjore. Të tilla, gjithashtu, ishin çështjet që i takonin asaj që është e paligjshme, dhe pasojave të divorcit të parevokueshëm [31], dhe “*habluki ‘ala gabriki*” [32], dhe çështjeve që kishin të bënin me ndëshkimet penale (hadd) [33] dhe divorcin. Këto çështje, tejet të shumta në numër për t’i përmendur, ngritën krye në kohët e tyre, dhe në rastin e secilës prej tyre nuk kishte ardhur asnjë përcaktim eksplicit nga Profeti. Sepse sikur ai të kishte dhënë udhëzime eksplicite në lidhje me të gjitha ato, ata nuk do të kishin qenë të ndarë në mendime mbi ato çështje, dhe dallimi nuk do të kishte zgjatur deri më sot.
22. Por ndonëse nuk ka patur asnjë udhëzim të hollësishëm nga ana e të Dërguarit të Zotit në lidhje

me secilën prej këtyre pyetjeve, ata ia referuan dhe e përngjasuan secilën me diçka që ishte përcaktuar qartësisht nga Libri i Zotit dhe Suneti, dhe vetë ixhtihadi i tyre.<sup>[34]</sup> Çështje të tilla<sup>[35]</sup>, pra, që përmbanin gjykime mbi raste të paprecedenta të dorës së dytë, ata ua referonin atyre përcaktimeve të Ligjit që janë të rrjedhuara, dhe të cilat duhet të trajtohen vetëm përgjatë linjës së shpalljes dhe traditës pejgamberike. Por kur ngrejnë krye çështje të reja dhe specifike që kanë të bëjnë me dogmat themelore, çdo mysliman inteligjent duhet t'ia referojë gjykimin mbi to shumëve të parimeve të pranuar mbi bazën e arsyes, përvojës shqisore, intuitës, etj....Sepse gjykimi mbi çështjet ligjore që i përket kategorisë së tradicionales duhet të bazohet mbi referencën ndaj principeve ligjore që, ngjashëm, i përkasin kategorisë së tradicionales. Dhe gjykimi mbi çështje që përfshijnë të dhënat e arsyes dhe shqisave duhet të jetë një çështje e referimit të çdo rasti të tillë ndaj (diçkaje brenda) kategorisë së saj, pa ngatërruar racionalen me tradicionalen, apo tradicionalen me racionalen. Kështu që, në qoftë se kelami mbi krijimin e Kur'anit dhe mbi atomin dhe brofjen, në këto terma të përpiktë, ka zënë fill në kohën e Profetit, ai do ta kishte diskutuar dhe kthjelluar atë, pikërisht sikundër ka shpjeguar dhe diskutuar të gjitha çështjet specifike që zunë fill në kohën e tij.

23. Atëherë dikush duhet të thotë: Nuk ka asnjë hadith të vërtetë nga Pejgamberi sipas të cilit Kur'ani është i pakrijuar apo i krijuar. Përse, atëherë, ju pretendoni se ai është i pakrijuar? Ata mund të thonë: Një pjesë<sup>[36]</sup> e Sahabëve dhe Ndjekësve (Tabiinëve) e kanë pohuar këtë. Atyre u duhet thënë: Sahabi, apo Tabiini (Ndjekësi), është i nënshtruar ndaj të njëjtit kufizim ndaj të cilit edhe ju jeni të nënshtruar, gjegjësisht, se ai është një bidatçi i paudhë kur thotë atë që i Dërguari nuk e thotë. Dikush tjetër mund të thotë: Unë e pezulloj gjykimin tim mbi këtë (çështje), dhe nuk them (se Kur'ani është) i krijuar, dhe as nuk them i pakrijuar. Këtij i duhet thënë: Atëherë ti, me pezullimin e gjyimit tënd mbi këtë, je një bidatçi i paudhë. Sepse Pejgamberi nuk ka thënë: "Në qoftë se kjo çështje shfaqet pas vdekjes time, pezulloni gjykimin tuaj mbi të, dhe mos thoni asgjë." Dhe as nuk ka thënë: "Cilësojeni si të paudhë dhe jobesimtar atë që pohon se ai (Kur'ani) është i krijuar, ose, atë që mohon se ai është i krijuar."
24. Krahas kësaj, thuajini atij: Në qoftë se dikush do të thoshte se dija e Zotit është e krijuar, a do ta pezulloje ti gjykimin tënd mbi atë, apo jo? Në qoftë se ai thotë jo, atëherë thuajini atij: As Pejgamberi dhe as Sahabët e tij nuk kanë thënë qoftë edhe një fjalë të vetme për këtë. Dhe ngjashëm, në qoftë se dikush do të thotë: A është ky Zot i juaji i ngopur me ushqim, apo me pije, apo është Ai veshur, apo i zhveshur, apo i ftohur, apo me marrje mendsh, apo i njomë, apo një trup, apo një aksidencë, apo a i nuhat ai Ai aromat, apo nuk i nuhat ato, apo a ka Ai hundë, dhe zemër, dhe mëlçi, dhe shpretkë, dhe a bën Ai haxhin çdo vit, dhe a kalëron Ai shaluar një kali, apo ajo, a është Ai i pikëlluar, apo jo – dhe pyetje të tjera të këtij tipi – ju do të duhet të refuzoni që t'i jepni atij përgjigje. Sepse as i Dërguari i Zotit dhe as Sahabët e tij nuk kanë diskutuar kurrën e kurrës qoftë edhe një prej këtyre pikave. Apo ju nuk do të rritet pa folur, dhe do të shpjegoni nëpërmjet kelamit tuaj se asnjëra prej këtyre gjërave nuk mund t'i mvishet Zotit, etj... etj..., për shkak të këtij e atij argumenti, etj...?
26. Dikush mund të thotë: Unë duhet të ruajë heshtjen dhe të mos i përgjigjem atij me asnjë fjalë, ose, unë duhet ta shmangë atë, ose, unë duhet të largohem prej tij, ose, unë nuk duhet ta përshëndesë atë, ose, unë nuk duhet ta vizitojë atë në qoftë se e kap sëmundja, ose, unë nuk duhet t'i bëj adetet e fundit xhenazes së tij në qoftë se ai vdes. Atij i duhet thënë: Atëherë ti do të ishe, në të gjitha këto mënyra që ke përmendur, një bidatçi i paudhë. Sepse i Dërguari i Zotit kurrë nuk ka thënë: "Në qoftë se dikush pyet për ndonjërin prej këtyre gjërave, mos pranoni t'i

përgjigjeni atij, ose, mos e përshëndetni atë, ose, largohuni prej tij.” Duke qenë se ai nuk ka thënë asgjë të këtillë, atëherë ju do të bëheshit bidatçi në qoftë se e veproni një të tillë.

26. Krahas kësaj, përse nuk keni refuzuar që të mos i përgjigjeni atij që thotë se Kur’ani është i krijuar?[\[37\]](#) Dhe përse e keni akuzuar atë për mosbesim? Nuk ka asnjë hadith të vërtetë nga Profeti që e mohon krijimin e tij dhe që e akuzon për mosbesim atë që thotë se ai (Kur’ani) është i krijuar. Ata mund të thonë: Për shkak se Ahmed ibn Hanbeli e ka mohuar se ai është i krijuar dhe ka pohuar se ai që thotë se (Kur’ani) është i krijuar duhet akuzuar për mosbesim. Atyre u duhet thënë: Përse Ahmedi nuk ruajti heshtjen në lidhje me këtë, në vend se ta diskutonte? Ata mund të thonë: Sepse Abas al-‘Anbari dhe Uaki’, dhe Abdurrahman bin Mehdi, dhe filani e filani, kanë thënë se Kur’ani është i pakrijuar, dhe se ai që thotë se ai është i krijuar është jobesimtar. Atyre u duhet thënë: Dhe përse ata nuk kanë ruajtur heshtjen në lidhje me atë që Muhamedi nuk e kishte diskutuar? Ata mund të thonë: Për shkak se ‘Amr ibn Dinari, Sufjan ibn Ujejne, Xha’fer ibn Muhamed dhe filani, dhe filani, kanë thënë se ai nuk është as krijuar as i krijuar. Atyre u duhet thënë: Dhe përse ata nuk u përmbajtën nga të thënit e kësaj gjëje, duke qenë se i Dërguari i Zotit nuk e ka thënë këtë?
27. Dhe në qoftë se ata i kthehen Sahabëve, atëherë kjo është kryeneçësi e pastër. Sepse dikush mund t’u thotë atyre: Dhe përse nuk u përmbajtën ata nga të thënit e kësaj, duke qenë se Profeti nuk e diskutoi atë, dhe nuk tha: “Atë që e thotë këtë quajeni jobesimtar.” Ata mund të thonë: Ulemaja thjesht duhet të përfshihet në kelam mbi një çështje të re, kështu që të paditurit të mund të dinë se si të gjykojnë çështjen. Atyre u duhet thënë: Ky është pranimi që ne donim që ju të bënit! Përse, pra, e pengoni kelamin (përfshirjen e njerëzve në të)? Ju e përdorni vetë kur dëshironi, por kur bini në heshtje (në një diskutim), ju thoni: Ne e kemi të ndaluar që të përfshihemi në kelam. Dhe kur ju doni, ju verbazi dhe pa fije dyshimi ndiqni paraardhësit tuaj, pa argument apo shpjegim. Kjo është kokëfortësi dhe shfaqje tekash!
28. Atëherë, atyre u duhet thënë: Profeti nuk ka diskutuar fetvatë mbi trashëgiminë dhe amanetet, ose lirim të skllëvërve, ose mënyrën e vlerësimit të transmetimit të pandërprerë të pronave, dhe as nuk ka hartuar ai një libër në lidhje me ato gjëra, sikundër kanë bërë Maliku, el-Theuri, dhe Shafi’iu, dhe Ebu Hanifja[\[38\]](#). Prandaj ju jeni të detyruar që të pranoni se ata ishin bidatçi të paudhë, duke qenë se ata bënë atë që Profeti nuk e kishte bërë, dhe thanë atë që ai nuk e kishte thënë shprehimisht, dhe shkruajtën atë që Profeti nuk e kishte shkruar, dhe thanë se ata që pohojnë se Kur’ani është i krijuar duhet të cilësohen jobesimtarë, ndonëse Profeti nuk e kishte thënë atë.

Ajo sa ne kemi thënë përmban material të mjaftueshëm për të kënaqur çdo njeri inteligjent që nuk është çoroditurazi kryeneç.

Kjo vepër ka përfunduar këtu – lavdërimi i takon Allahut, dhe bekimet e Tij qofshin mbi Zotërinë tonë, Muhamedin, dhe familjen e tij, dhe Sahabët e tij!

Përktheu: Arjol Guni

### **Shënime të përkthyesit në anglisht**

[\[1\]](#) Përfaqësuesit e një tradicionizmi të sertë – një pjesë e hanbelitëve?



[2] Arabisht – *taklid* – pranimi i padiskutueshëm i autoritetit të një tjetri. Krahaso me artikullin *Taklid*, III, në EI ose Hwb.

[3] Arabisht: *al-alu?n wa'l-aku?n*. Sipas Abd el-Kahir el-Bagdadi (Usul al-Din, 40 e më tutje) këto janë dy ndarjet e mëdha të aksidencave. Fraza, për rrjedhojë, mund të përkthehet thjesht si “llojet e ndryshme të aksidencave”.

[4] Arabisht: *al-tafra*. Kjo duket se i referohet teorisë së “brofjes” se al-Nadhamit – krahaso me Tritton, 93, dhe *Madhhab al-Dhurra 'inda'l-Muslimin* (përkthimi në arabisht i Pines, *Beiträge zur Islamischen Atomenlehre*) 12, dhe 141.

[5] Pra, kelam mbi këto tema si ato të përmendura në Nr. 2.

[6] Literalisht “brofi, ndonëse ai nuk...”

[7] Po të flasim ngushtë, nuk kishte “juristë” në gjirin e Sahabëve. Ndoshta, kuptimi i vjetër i “fikh” duhet të kuptohet këtu, pra “kuptim”, sidomos në çështjet e fesë.

[8] Krahaso me *Luma'*, Nr. 11.

[9] Literalisht “pa ortak” (*sharik*)

[10] Ndoshta më mirë: “ndaj këtij ajeti, dhe ndaj thënies së Zotit...”

[11] Ndoshta përpara “*ila kaulih*” duhet futur një *uau*, dhe më pas përkthimi do të ishte: “superior ndaj të tjerëve..., dhe ndaj thënies së Zotit...”

[12] Literalisht “sipas të dyja grupeve të tyre – një grup që pranoi... dhe një grup që mohoi...”

[13] Pra, si krijimi i parë ashtu dhe ai i dytë.

[14] Nuk është plotësisht e qartë në qoftë se [në tekst] bëhet fjalë për Zotin apo Muhamedin. Sidoqoftë, kjo nuk ka shumë rëndësi, për shkak se argument është që është shpallur nga Zoti dhe përdorur nga Muhamedi.

[15] Ky paragraf është një shënim komentues që është pothuajse i pavarur nga teksti. Krahaso me Baidawi mbi këtë tekst.

[16] Ose, Muhamedi.

[17] Shkrijë, bashkim, ose ndërthurje do të ishte ndoshta më mirë.

[18] Nuk është gjetur ndonjë referencë për këtë ngjarje.

[19] Kjo histori nuk është ndeshur në ndonjë burim tjetër të ditur.

[20] Kjo fjalë mund të ketë kuptime të tjera, dhe ndoshta madje edhe një kuptim teknik këtu; por pika në fjalë nuk ka fort rëndësi.

[21] Krahaso me *Luma'*, Nr. 7.

[22] Dhe Krahaso me 72.28.

[23] Krahaso me *Luma'*, Nr. 5.

[24] Krahaso me Baidawi mbi këtë ajet.

[25] Krahaso me Baidawi, II, 301, n. 100.

[26] Krahaso me Baidawi mbi këtë ajet.

[27] Teksti në arabisht ka një shënim këtu, ku citohet Baidawi, dhe aty thuhet se Muhamedi nuk qëndroi në heshtje, por u përgjigj aty në vend.

[28] Këto ajete duket se janë shpallur në një rast tjetër nga ai i takimit me al-Ziba'ra – krahaso me Blachere II, 264, n. 57.

[29] Ky përkthim duket se e përçon kuptimin, ndonëse në arabisht fjalia është ndërtuar paksa çuditshëm.

[30] Arabisht *al-'awl* – krahaso me, *Instituzioni di diritto musulmano malachita*, II, 512-513.

[31] Arabisht: *ue'l-ba'in ue'l-batta* –krahaso me Santillana, vepër e cituar, Indeksi B, nën *Ba'in* dhe *Battah*.

[32] Literalisht: Litari yt është mbi qafën tënde. Kjo frazë në origjinë i është referuar një deveje që lejohej të kulloste lirisht, dhe prandaj këtu ka kuptimin: Ti je i lirë të bësh si të dëshirosh. Krahaso me Lane, **s.v.** *gharib*, Formula duket se është përdorur në lidhje si me divorcin ashtu dhe me lirim të skllavit: krahaso me A. W. T. Juynboll, *Jas Shafiiticum* (botim i *al-Tanbih* i Abu Ishak al-Shirazi), Leiden, 1879. 174.8 dhe 212.4.

[33] Pra, ndëshkimet e përcaktuara nga ligji kuranor.

[34] Pra, përpjekjen e tyre personale – krahaso me artikullin *Ijtihad* në EI ose Hwb.

[35] Arabishtja e kësaj fjalie (dhe shumëçka prej këtij numri) është mjaft e vështirë, ndonëse gjykoj se mendimi i autorit është dhënë.

[36] Ose: “Njëri prej...” Fjala *ba'd* në arabisht është ndonjëherë ambigje.

[37] Mbi këtë çështje, dhe emrat e përmendura nga autori, krahaso me referencat e dhëna në shënimin 1, më sipër.

[38] Katër jurisprudentë të shquar dhe themeleus të shkollave ligjore. Lexuesi do të gjejë artikuj për ata në EI (al-Thawri me emrin Sufyan), dhe Hwb (me përjashtim të al-Thawri).

#### **Date Created**

30/01/2019

#### **Author**

erasmusi